



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) me datën 10.07.2024, merr këtë:

**VENDIM**

**Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA**

- I. Subjektit politike SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Nëse subjekti politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike në shumë e gjobës së shqiptar.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

**Arsyetim**

Subjekti politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, është subjekt politik i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga data 13.01.2020 dhe është subjekti politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, i cili përfiton mjete financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në përputhje me nenin 9 të LFSP.

Sipas të gjeturave të prezantuara në raportin përfundimtar të auditimit për shpenzimet e bëra për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA ka bërë shpenzime, për të cilat nuk ka ofruar fatura ose dëshmi mbështetëse. Këto shpenzime arrijnë vlerën 732 (shtatëqind e tridhjetë e dy) euro. Shpenzimet e tilla për të cilat nuk ka fatura mbështetëse janë në kundërshtim

me paragrafin 3 nenin 15 të LFSP, që thekson se çdo raport vjetor financiar përmban, në mes tjerash, edhe kopjet e të gjitha faturave për të gjitha shpenzimet.

Shpenzimet e realizuara dhe të paarsyetuara me fatura të këtij subjekti politik që arrijnë vlerën 732 (shtatëqind e tridhjetë e dy) euro janë të realizuara përmes trembëdhjetë (13) transaksioneve bankare gjatë vitit 2023.

Për gjetjen më lartë, subjektit politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA i shqiptohet gjoba në vlerën katër (4,000) mijë euro. Subjekti politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptar.

**Nga sa u tha më lartë, përmes këtij vendimi, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë totale prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

Prishtinë, 10.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politike SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politike SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA.

**Këshilla juridike:** Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.